

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" Fidem Group " SH.P.K**

Sot, më datë 07.04.2023,

**Kristian Gjoni**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 20/03/1991, lindur në Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BG7701138 dhe Nr. Personal *J10320064J* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

**NENI 1**

**Themelimi**

Emri i shoqërisë është "**Fidem Group**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Fidem Group**" Sh.P.K.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë**

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e prodhimit të mallrave plastike për ndërtim si: dyer plastike, dritare, skelete, grila, mbajtëset e plintave, cisternë, rezervuarë, dysheme plastike, mure ose tavane prej plastike në forma të petëzuar apo në formë tullash etj, pajisje sanitare plastike si banjat, banjat e dushit, vaska, lavaman, cisterna etj, prodhimin e mbulesave të dyshemesë plastike si linoleum, vinil etj, prodhimin e gurëve artificial, prodhimin e dyerve metalike, dritareve dhe skeletet e tyre, qepenëve dhe kangjellave, ndarjen e dhomave metalike për shtojcat e apartamenteve, prodhimin e kasafortave, kutiave të forta, dyer të blinduara etj,, punime që kontribuojnë në perfundimin e ndërtimit si veshja me xham etj.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e Shoqërisë**

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Fidem Group**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e prodhimit të mallrave plastike për ndërtim si: dyer plastike, dritare, skelete, grila, mbajtëset e plintave, cisternë, rezervuarë, dysheme plastike, mure ose tavane prej plastike në forma të petëzuar apo në formë tullash etj, pajisje sanitare plastike si banjat, banjat e dushit, vaska, lavaman, cisterna etj, prodhimin e mbulesave të dyshemesë plastike si linoleum, vinil etj, prodhimin e gurëve artificial, prodhimin e dyerve metalike, dritareve dhe skeletet e tyre, qepenëve dhe kangjellave, , ndarjen e dhomave metalike për shtojcat e apartamenteve, prodhimin e kasafortave, kutiave të forta, dyer të blinduara etj,, punime që kontribuojnë në perfundimin e ndërtimit si veshja me xham etj.

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Shkoder, Bashkia Vau Dejes, Shelqet, Rruga Nacionale, Zona Kadastrale 3506, Nr Pasurie 269/17, Nr 44.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 6**

**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**Fidem Group**" Sh.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Kristian Gjoni**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 20/03/1991, lindur në Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BG7701138 dhe Nr. Personal *J10320064J* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themelues do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themelues.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## NENI 9

### Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet Z. **Gac Gjeçaj**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 01/04/2002, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038127546 dhe Nr. Personal *K20401071R* me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

## NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

## ORTAKËT THEMELUES

**Kristian Gjoni**

KRISTIAN

GJONI

